



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A.nr. 263/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Nehat Idrizi kryesues, Nenad Lazić dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi për kërkesën e Partia Demokratike e Kosovës ( PDK), në seancën e panelit të mbajtur me 25.10.2013, mori këtë:

### V E N D I M

**Konstatohet e tërhequr ankesa** me numër: Anr.263/2013, e datës 17.10.2013, të parashtruar në PZAP nga Partia Demokratike e Kosovës ( PDK).

### Arsyetim

PZAP, me datë 19.10.2013, ka pranuar një kërkesë për tërheqjen e ankesës me numër: Anr. 263/2013, datës 17.10.2013, të parashtruara në PZAP, kundër subjektiv politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), në të cilën kërkohet që të tërhiqet ankesa e lartpërmendur nga shqyrtimi, pasi subjekti politik LDK ka bërë përmasimin e shkeljes së pretenduar.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi kërkesën për tërheqje të ankesës së sipërshtënëuar, me të cilën kërkohet nga PZAP-i që mos të shqyrtohet ankesa në fjalë, në kuptim të nenit 115.1 të LZP-së, PZAP-i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

A nr. 263/2013 më datën 25.10.2013

Kryesuesi i Panelit  
Nehat Idrizi

